



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 50..... Prot.

Tiranë, më 06 . 01 . 2017

URDHËR

Nr. 2 Datë. 06.01.2017

PËR
“NGRITJEN E STRUKTURËS PËRGJEGJËSE PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN
E SINJALIZUESVE”

Në mbështetje të pikës 1 dhe 2 të nenit 10, pikës 10 të nenit 13, të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, të pikës 1, 2 dhe 11 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 816, datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr.60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve””,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e strukturës përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit , me këtë përbërje:
 - Skënder Jaku Përgjegjës
 - Jeton Shehu Anëtarë
2. Njoftimin me shkrim të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, për krijimin e njësisë përgjegjëse, së bashku me kontaktet e saj.
3. Ngarkohet njësia përgjegjëse të hartojë rregulloren e brendshme të posaçme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit, sipas udhëzimeve të ILDKPKI-së.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Shërbimeve Juridike, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

